FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 45	2002	Korrik

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 347, datë 11.7.2002	Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre……..	1299
Vendimi KM nr. 350, datë 18.7.2002	Për emetimin e obligacioneve afatgjata me maturim më të madh se një vit…….	1349
Vendim i KM nr. 355, datë 18.7.2002	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2002, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë……..	1349
Vendimi KM nr. 357, datë 18.7.2002	Për dhënien e statusit "spital universitar", Spitalit Ushtarak Qendror…….	1350

V E N D I M
Nr. 347, datë 11.7.2002

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË BARNAVE QË RIMBURSOHEN NGA INSTITUTI I SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR, DHE MASËN E MBULIMIT TË ÇMIMIT TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 15 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së barnave që rimbursohen, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Masa e mbulimit të çmimeve të listës së barnave që rimbursohen, sipas grupeve, është si më poshtë vijon:

Sipas klasifikimit, ATC e grupuar, është në masën 50 për qind deri në 100 për qind.

Grupi I - Masa e mbulimit 100 për qind

Në këtë grup përfshihen barnat me nivelin më të lartë të rimbursimit dhe bëjnë pjesë në këto grupe terapeutike: J04, L01, L02, L03, L04, M05, V03.

Konkretisht:
- antimykobakterialët;
- barnat antineoplazikë;
- barnat në terapinë endokrine;
- imunostimuluesit;
- imunosupresivët;
- barnat për çrregullimet e sistemit muskulo-skeletik;
- të gjitha produktet e tjera terapeutike.

Grupi II - Masa e mbulimit 85 për qind deri në 95 për qind

Në këtë grup përfshihen barnat që bëjnë pjesë në këto grupe terapeutike: A09, A10, B01, B03, H01, H05, M04, N03, N04, N07.

Konkretisht:
- digjestivët, përfshi enzimat;
- antidiabetikët;
- antikoagulantët;
- hormonet e hipofizës dhe hipotalamusit;
- kalcium hemeostatikët;
- preparatet antigutozë;
- antiepileptikët;
- antiparkinsonikët;
- barnat e tjera për sistemin nervor.

Grupi III - Masa e mbulimit 75 për qind deri në 85 për qind

Në këtë grup përfshihen barnat që bëjnë pjesë në këto grupe terapeutike: C01, C02, C04, C08, C09, H03, J05, N05, R03.

Konkretisht:
- barnat në terapitë kardiake;
- antihipertensivët;
- vazodilatatorët periferikë;
- kalciblokuesit;
- barnat vepruese në sistemin renin-angiotensin;
- barnat në terapinë e tiroides;
- barnat antivirale, sistemike;

- psikoleptikët;
- antiastmatikët.

Grupet IV - Masa e mbulimit 65 për qind deri në 75 për qind

Në këtë grup përfshihen barnat që bëjnë pjesë në këto grupe terapeutike: A02, A07, B05, C03, C07, C10, G01, G02, G04, H02, N02, N06.

Konkretisht:

- antiacidët, barnat për mjekimin e ulçerës peptike dhe flatulencës;
- antidiarreikët, antiinflamatorët dhe antiseptikët intestinalë;
- zëvendësuesit e plazmës dhe perfuzionet;
- diuretikët;
- betablokuesit;
- barnat për reduktimin e lipideve në gjak;
- antiinfektivët dhe antiseptikët gjinekologjikë;
- barnat e tjera gjinekologjike;
- urologjikët;
- kortikosteroidët sistemike;
- analgjezikët;
- psikoanaleptikët.

Grupi V - Masa e mbulimit 55 për qind deri në 65 për qind

Në këtë grup përfshihen barnat që bëjnë pjesë në këto grupe terapeutike: A03, A05, A11, B02, C05, G03, J01, J02, M01, P02, R05, S01.

Konkretisht:

- barnat antiseptike, antikolinergjike dhe propulsivë;
- kolagogët dhe hepatoprotektorët;
- vitaminat;
- antihemorgjikët;
- vazoprotektorët;
- hormonet seksuale dhe modulatorët e sistemit gjenital;
- antibakterialët sistemike;
- antimykotikët sistemike;
- antiinflamatorët dhe antireumatikët;
- antihelmintikët;
- barnat kundër kollës dhe rrufës;
- barnat oftalmikë.

Grupi VI - Masa e mbulimit 50 për qind

Në këtë grup përfshihen barnat që kanë nivelin më të ulët të rimbursimit dhe që bëjnë pjesë në këto grupe terapeutike: A06, A12, D01, D06, D07, R01, R06, V07.

Konkretisht:

- laksativët;
- shtesat e kripërave minerale;
- antimykotikët dermatologjikë;
- antibiotikët dhe kimioterapeutikët dermatologjike;
- preparatet dermatologjikë;
- preparatet dermatologjike të kortikosteroideve;
- preparatet nazale;
- antihistaminikët sistemike;
- të gjitha produktet e tjera joterapeutike.

3. Masa e mbulimit të çmimeve të barnave të reja alternative të pasqyrës II, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, është 50 për qind.

4. Efekti financiar prej 280 000 000 (dyqindetetëdhjetë milionë) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Çdo disbalancim financiar të përballohet nga fondi rezervë i këtij Instituti.

5. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, i cili përcakton kufizimet në përdorimin e barnave të kësaj liste, për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi nr. 307, datë 12.5.2001 i Këshillit të Ministrave "Për listën e barnave që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 350, datë 18.7.2002

PËR EMETIMIN E OBLIGACIONEVE AFATGJATA ME MATURIM MË TË MADH SE NJË VIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 5 e 23 pika 3 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lejimin e Ministrisë së Financave të emetojë, në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, obligacione afatgjata, me afat maturimi më të madh se një vit dhe përdorimin e tyre brenda kuadrit ligjor në fuqi.

2. Ministria e Financave, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, të përcaktojë procedurat teknike të emetimit, blerjes, maturimit dhe regjistrimit kontabël të këtyre obligacioneve afatgjata.

3. Komiteti i administrimit të huave të brendshme të përcaktojë strategjinë e emetimit të obligacioneve afatgjata, në përputhje me programet në këtë fushë dhe planifikimin buxhetor.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 355, datë 18.7.2002

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2002, MIRATUAR PËR MINISTRINË E EKONOMISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", dhe të nenit 7 të ligjit nr.8749, datë 19.12.2001, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministrisë së Ekonomisë, në buxhetin e vitit 2002, t'i shtohet fondi prej 8 500 000 (tetë milionë e pesëqind mijë) lekësh, kontribut i Qeverisë Shqiptare për realizimin e projektit "Shërbimi këshillimor për investimet e huaja".

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 357, datë 18.7.2002

PËR DHËNIEN E STATUSIT "SPITAL UNIVERSITAR", SPITALIT USHTARAK QENDROR

Në mbështetje të pikës 2 të neni 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.3766, datë 17.2.1993 "Për shërbimin shëndetësor dhe dhënien falas të ndihmës mjekësore të shtetit", të nenit 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.8718, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Spitalit Ushtarak Qendror i jepet statusi "spital universitar" dhe emërtohet "Spitali Ushtarak Qendror Universitar" (SUQU).
2. Spitali Ushtarak Qendror Universitar funksionon me këtë strukturë organizative:
a) Spitali Ushtarak (SU);
b) Instituti i Kërkimeve Mjekësore Ushtarake (IKMU);
c) Qendra Kombëtare e Traumatologjisë (QKT).
3. Drejtori i Përgjithshëm i Spitalit Ushtarak Qendror Universitar është mjek ushtarak dhe emërohet e lirohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.
4. Buxheti i Spitalit Ushtarak Qendror Universitar përcaktohet zë më vete në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.
5. Këshilli i Ministrave miraton rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Spitalit Ushtarak Qendror Universitar.
6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 29. 7. 2002
Doli nga shtypi më 30. 7. 2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 200 lekë